



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

Njoftim: LISTA E APLIKIMEVE PËRFITUESE DHE DOKUMENTET E KËRKUARA PËR MASAT 5, 6, 7, 8 DHE 9

Bazuar në VKM-në nr. 205, datë 30.3.2026 “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2026” dhe në Udhëzimin nr. 8, datë 14.5.2026 të MBZHR dhe MF “Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për masat mbështetëse për vitin 2026”, përkatësisht:

- Kreun VIII “Procedura që ndiqet për përzgjedhjen, verifikimin dhe pagesat për masat mbështetëse me nr. 1, nr. 2, nr. 3, nr. 4, nr. 5, nr. 6, nr. 7 dhe nr. 9”, pika 3, sipas së cilës “Me përfundimin e aplikimeve dhe kontrollit administrativ të dokumenteve që gjenerohen on-line, AZHBR shpall brenda 20 ditëve kalendarike, listën e aplikimeve të përfituesve dhe dokumentet e kërkuara sipas masës përkatëse, në faqen zyrtare të saj www.azhbr.gov.al”; si dhe
- Kreun IX “Kriteret, dokumentacioni dhe procedura për Masën nr. 8”, sipas së cilit dokumentacioni për Masën 8 ngarkohet online nga aplikanti në momentin e aplikimit (vetëdeklarim); aplikanti njoftohet për rezultatin e kontrollit administrativ dhe, në rast mangësish, i plotëson ato brenda 10 ditëve kalendarike nga momenti i njoftimit (pika 5), ndërsa lista përfundimtare e përfituesve me vlerën përkatëse (në lekë) publikohet në faqen zyrtare www.azhbr.gov.al pas përfundimit të kontrollit administrativ (pika 10),

njoftojmë se, me përfundimin e fazës së aplikimit dhe të kontrollit fillestar administrativ, rezultojnë të kualifikuara aplikimet si më poshtë:

MASA 5:	"Mbështetje për luftimin biologjik në sera dhe tunele plastike" janë kualifikuar 362 aplikime;
MASA 6:	"Mbështetje për Fermat Organike dhe në kalim" janë kualifikuar 201 aplikime;
MASA 7:	"Mbështetje për certifikimin GlobalGAP" janë kualifikuar 16 aplikime;
MASA 8:	"Pagesë për sipërfaqe të mbjellë (ha)" janë kualifikuar 20,042 aplikime;
MASA 9:	"Mbështetje ripopullim peshkimi në ujëra të brendshme" janë kualifikuar 15 aplikime;

Për Masat 5, 6, 7 dhe 9: të gjithë subjektet/aplikantët që gjenden në listat e aplikimeve të kualifikuara dhe për të cilët kërkohet dokument sipas masës përkatëse, si dhe rastet që kanë nevojë për dokumente shtesë sipas tabelave të mëposhtme, duhet t'i dorëzojnë këto dokumente të plota brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike nga data e publikimit të listave në faqen zyrtare www.azhbr.gov.al.

Për Masën 8: dokumentacioni është ngarkuar online nga aplikanti në momentin e aplikimit (vetëdeklarim). Aplikantët për të cilët, gjatë kontrollit administrativ, konstatohen mangësi njoftohen individualisht dhe duhet t'i plotësojnë ato brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga momenti i njoftimit. Lista përfundimtare e përfituesve me vlerën përkatëse (në lekë) do të publikohet në faqen zyrtare www.azhbr.gov.al pas përfundimit të kontrollit administrativ.

Mosplotësimi i kriterëve të përfitueshmërisë brenda afatit të përcaktuar, është kriter skualifikimi.